



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

02/Nr.5990/2021



RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS

Viti 2021

Grupi i punës:

- Kryetari i komunës - Rufki Suma
- Nënkryetari i komunës - Mallzum Qajani
- Zyra e personelit-Ajete Berisha
- Zyra ligjore- Bajrush Laçi
- Zyra e prokurimit-Xhevdet Bushi
- Zyra për transparencë- Bashkim Sopa
- Zyra për të drejtat e njeriut dhe fëmijëve dhe barazi gjinore-Vjosa Rogaçi
- Zyra komunale për komunitet, këthim-Xhemshit Kalisi
- Drejtori i drejtorisë për Administratë - Edon Curri
- Drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa -Shabi Rexhallari
- Drejtori i drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini e Sport- Menduh Vlashi
- Drejtori i drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mb. të Mj. - Nexhmedin Daci
- Drejtoreshë e drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale -Medina Imishti
- Drejtori i drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë - Refet Kalisi
- Drejtoreshë e drejtorisë për Zhvillim Ekonomik -Sevime Laçi
- Drejtori i drejtorisë për BPZHR - Zaim Bela

Përmbajtja		Faqe
1	Aktivitetet	4
2	Zyra e personelit	5
3	Zyra ligjore	7
4	Zyra e prokurimit	8
5	Zyra e informimit	11
6	Zyra për të drejtat e njeriut, fëmijëve dhe barazi gjinore	12
7	Zyra për komunitete dhe këthim	13
8	Drejtoria për Administratë	13
9	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	17
10	Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport	22
11	Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit	26
12	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	31
13	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	44
14	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	50
15	Drejtoria për Bujqësi Pyltari dhe Zhvillim Rural	52

AKTIVITETET

Sikurse edhe gjatë vitit 2020 edhe viti 2021 filloi në rrethana të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë Covid 19, të cilat kanë ndikuar edhe në aktivitete të ndryshme në komunë dhe jashtë saj. E sidomos takimet e ndryshme me institucionet qendrore dhe ndërkomtare po thuaj se janë realizuar në formë digjitale, ndër ato takime të pakta janë:

Takime pune:

Gjatë gjashtëmujorit të parë kemi realizuar një varg takime dhe aktivitete me ministra e zv.ministra si në Prishtinë ashtu edhe në Han të Elezit.

- Me Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, znj. Arbërije Nagavci rreth gjendjes në arsim në këtë komunë.
- Ministrin e Shëndetësisë Arben Vitia për situatën me Pandemi dhe për mundësinë e zgjerimit të numrit të puntorëve dhe sigurimin e pajisjeve mjekesore për QKMF...
- Ministrin e Drejtësisë znj. Albulena Haxhiu për mundësinë e hapjes së degës së Gjykatës Themelore në Han të Elezit
- Zv.ministrat e Infrastruktura dhe Ambientit z. Hysen Durmishi në lidhje me projektet e infrastrukturës dhe Marveshjet e përealizuara nga qeveria e kaluar si nënkalmi në Paldenicë dhe znj. Linda Qavdarbasha në lidhje me rregullimin e shtratit të lumit Lepencë dhe për ndotjen e ambientit
- Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, z. Hajrulla Qeku në lidhje me sigurimin e fondeve për përfundimin e shtëpisë së kulturës, memorialin Bllaca 99 për trashëgimi kulturore etj.
- Kuvendi i Asociacionit të Komunave të Kosovës Online, zoom
- Vizita e ministrit të Mbrojtjes z. Armend Mehaj, Han të Elezit dhe vizitë të kompanisë së Deminimit në Seqishtë
- Vizita e zv.ministrit të Bujqësisë, pulltarisë dhe Zhvillimit Rural Imri Demelezi në zyrë dhe teren të projektit të pastrimit dhe rrallimit të malit...
- Konferencë Online-zoom Projekti nga IPA,-BE-Gazibabë-Hani i Elezit rreth projektit të proçkës në Seqishtë
- Zyrtarët e agjencionit të pyjeve: z. Menderes Ibra, Drejtor i Përgjithshëm i Pyjeve të Kosovës
- Komandanti KFOR-it regjionit të prendimit në Kosovë

Marrëveshje të lidhura

- Marrëveshja e Mirëkuptimit me Agjencinë Kosovare për Ndihmë Juridike Falas
- Marrëveshjen e Mirëkuptimit me MZHE 50 mijë euro për realizimin e projektit të shtrimit të rrugicave me kubeza betoni në zonat urbane dhe rurale të Hanit të Elezit
- Marrëveshje për bashkëpunim me MAPL-DEMOS-Komunë 41.689,000 për rehabilitimin e fabrikës së ujit dhe rrjetin përcjellës.
- Marrëveshje mirëkuptimi me MAPL dhe BB për financimin e Aktiviteteve rinore në shumë 50.000 euro, 7500 euro komuna.

Pandemia

- Në vazhdimësi organet komunale kanë përcjell gjendjen me koronavirus në territorin e komunës së Hanit të Elezit
- Zbatimi i vendimeve të institucioneve qendrore për parandalimin e përhapjes së koronavirusit
- Janë mbajtur disa takime të shtabit emergjent komunal
- Janë mbajtur takime të rregullta të TASK-Forcës komunale për arsim, ku është raportuar për zhvillimin e procesit mësimor në komunën tonë dhe janë marrë vendime

- të ndryshme në shërbim të mirëvatjes së procesit mësimor dhe ruatjes së shëndetit të fëmijëve dhe personelit arsimor
- Menaxhimi dhe koordinimi me IKSHPK me rastet pozitive dhe rastet e kontaktit në komunën tonë:
 - Bashkëpunimi me donator të ndryshëm për sigurimin e ndihmave për familjet të cilat kanë nevojë të ndihmohen si nga SHOQATA Jetimat e Ballkanit, UNMIK-u, Shqiptarët per Shqiptarët
 - Testimi për COVID 19-gjatë kësaj periudhe në QKMF kanë mund të realizohen këto teste:
 - Testet serologjike u testuan 1950 qytetarë
 - Testet rapide u testuan 216 qytetarë
 - Vaksina kundër COVID 19 u vaksinuan 1102 qytetarë

Projektet:

- Vazhdimi i ndërtimit të Shtëpisë së Kulturës
- Vazhdimi dhe përfundimi i punimeve të Salles së Sportit në shkollën Veli Ballazhi në Gorancë
- Pajisja e kabinetëve në shkollë me pajisje të domosdoshme për punë.
- Projekti i kabnalizimit në Seqishtë me fonde të BE-së IPA
- Zgjerimi i ndriqimit në Zona urbane dhe rurale.
- Ujësjellësi i Dimcës
- Rregullimi i rezevuarit të ujësjellësit në Gorancë

ZYRA E PERSONELIT

Në zyrën e personelit gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2021 janë kryer disa aktivitete, duke filluar nga kontrolli dhe evidentimi i prezencës në punë i gjithë punëtorëve, mirëmbajtjen e dosjeve, menaxhimin e pushimeve vjetore dhe pushimeve tjera, kërkesat dhe shkresat përcjellëse Ministrisë së Administratës Publike dhe institucioneve tjera, bashkëpunimi me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik , njoftimin e punëtorëve rreth pushimeve dhe festave zyrtare, ndjekjen e trajnimeve, zbatimin e Ligjit për zyrtarët Publik.

Në mënyrë të rregullt dhe sistematike, nga Zyra e Personelit me anë të aparatit digjital, është bërë evidentimi i gjithë punëtorëve. ku gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur asnjë rast vonese pa arsye.

Janë kompletuar dosjet e pushimit vjetor për vitin 2020

Gjithashtu sipas evidencës që posedon zyra e Personelit dhe me kërkesë të vetë nëpunësve janë lëshuar:

- 2 vërtetime për mardhënie pune
- 2 vendime mbi kompenzimin e pagesës së shpërblimit të përvjetorit jubile
- 2 vendime për mëditje jashtë vendit
- 3 vendime për transferimin dhe sistemimin e nëpunësve në Listë të pagave
- 1 vendim për caktimin e detyrave shtesë
- 1 vendim për ndryshimin e titullit
- 1 kërkesë për mbledhjen e komisionit disiplinor
- 1 shkresë për Komisionin e ankesave
- 1 kërkesë për Drejtorin e Departamentit për menaxhimin e zyrtarëve public për unifikimin e koeficientëve
- 1 kërkesë për Drejtorin e Departamentit për menaxhimin e zyrtarëve public për aprovim të koeficientëve
- 4 njoftime rreth ditëve të pushimit për festat zyrtare për gjithë nëpunësit civil

1 Raport i aktiviteteve të ndërmarra në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik

Gjithashtu është përgaditur plani vjetor i trajnimeve për nëpunësit civil i cili përcillet në MAP çdo fillim të vitit

Janë vazhduar kontratat e punës për punëtorët teknik

Nga zyra e personelit janë përgaditur 4 procedura përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për Lëvizje paralele në përputhje me Ligjin për zyrtarët Publik, të gjitha këto procedura janë publikuar në webfaqen e konkurrenive dhe pas përfundimit të afatit për aplikim është përgaditur njoftimi për përfundimin e këtyre procedurave pa asnjë kandidat, Pozitat për të cilat janë zhvilluar procedurat e Lëvizjes Paralele janë:

- Zyrtar për Bujqësi
- Zyrtar për tatimin në prone
- Zyrtar për Emergjencë
- Zyrtar për planifikim dhe zhvillim

Është bërë publikimi i konkurseve të sektorit të arsimit dhe shëndetësisë në webfaqen e konkurrenive

Janë përgaditur raporte 3 mujore për DASHC-në rreth numrit, gjinisë dhe përkatësisë etnike të të punësuarve në komunën e Hanit të Elezit, nga sistemi i “Payroll” janë shkarkuar listat e pagave të cilat përcillen në drejtoritë përkatëse për tu nënshkruar dhe kthehen përsëri në zyrën e Personelit ku arkivohen.

Gjithashtu në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive janë caktuar nëpunësit të cilët kanë ndjekur trajnime në Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe nga disa organizata tjera joqeveritare.

Është përgaditur Plani i punës së Zyrës së Personelit për vitin 2021

Në mbështetje të Ligjit për Zyrtarët public nr 06/L-114 dhe me bashkëpunimin e drejtorive për Arsim dhe Shëndetësi është përgaditur lista e të punësuarve me titujt e punës sipas kontratës apo aktemërimit dhe është bërë deklarimi i statusit të nëpunësit, kjo listë I është përcjellur DMZP për aprovim.

Tranimet e zyrtarëve të ndryshëm gjatë gjashmunorit 2021 janë:

- Puna me fëmijët
- Supervizimi
- Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e fëmijëve”
- Sigurimet shendetesore
- Ri-integrimi i të rikthyerve nga vendet e luftës
- Ligji për procedurën administrative
- Trajnim për Menaxhimin e Cash-it
- Menaxhimi i kontrates nepermjet sistemit të prokurimit elektronik
- Zhvillimi i fëmijëve dhe faktorët e rrezikut që mund të ndikojnë në paraqitjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimi

ZYRA LIGJORE

Zyra ligjore është e radhitur në organogramin e komunës në zyrën e Kryetarit të Komunës, e cila gjatë gjashtëmujorit të vitit 2021 ka vazhduar punët dhe detyrat në bazë të përshkrimit të detyrave të punës dhe udhëzimeve të tjera nga ana e eprorit, përkatësisht nga Kryetari i komunës dhe gjithashtu bashkëpunimin me Drejtorët e drejtorive dhe me zyrtarë të tjerë. Si zyre kemi bashkëpunuar me të gjithë sektorët e komunës dhe kemi arritur që pajtueshmëria e akteve komunale të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Shkurtimeisht do të paraqesim numrin e akteve juridike të përpiluara gjatë gjysëm vitit të dytë të 2021. Në këtë zyrë gjatë periudhës së raportimit, janë përpiluar akte juridike të cilat do t'i shënojmë në tabelën e mëposhtme dhe do t'i krahasojmë me gjysëm vitin e kaluar:

Viti	Vendime	Përgjigje ne kërkesa	Përgjigje ne padri	Autorizime	Njoftime	Vërtetime	Rekomandime	Kërkesat në inst. qendrore	Kontratë mbi shërbimin	Përgjigje ne kërkesë auditorve
2020	93	23	16	18	5	0	0	2	2	0
2021	88	10	07	12	2	1	0	1	0	1
Dif.	-5	-13	-9	-6	-3	1		-1	-2	+1

Duke pasur parasysh pozitën dhe detyrat e zyrës ligjore të gjitha aktet juridike të lartshënuara kanë qenë të hartuara dhe të mbështetura në dispozitat e aplikueshme të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i komunës së Hanit të Elezit gjatë gjysëm vitit 2021 ka miratuar vendime, akte juridike brenda fushës së kompetencës së tij të cilat do t'i paraqesim sipas muajve vijues dhe do t'a bëjmë krahasim me gjysmë vitin 2020, duke i specifikuar vendimet dhe rregulloret.

Muaji	Janar		Shkurt		Mars		Prill		Maj		Qershor		Korrik		Gusht		Shtator		Tetor		Nentor		Dhjetor	
Viti	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Vendime	5	6	4	5	4	-	5	2	2	4	1	1												
Rregullore											1													

Nga kjo tabelë rezulton se gjatë gjysmë vitit 2021 gjashtëmujori i parë nga kuvendi i komunës së Hanit të Elezit janë miratuar gjithsej: 18 vendime, ndërsa në gjysëm vitin 2020 të gjashtëmujorit të parë janë miratuar 21 vendime, pra në vitin 2020, janë miratuar 3 vendime më shumë se në vitin 2021.

Sa i përket vendimeve të miratuara zyra ligjore prej muajit Janar të vitit 2021 deri në muajin që po raportojmë në afatin e paraparë ligjor ka përcjellur të gjitha vendimet dhe

rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit me shkresë përcjellëse në MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për shqyrtim të ligjshmërisë), të parapara sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, vendimet janë cilësuar me efekt të plotë juridik dhe nuk kanë qenë në kundërshtim me legjislacionin, (këtu duhet të ceket se MAPL nuk ka përcjellë konfirmimet për të gjitha aktet tona të miratuara, por vetëm për disa që kanë qenë në kompetencë të tyre).

Zyra ligjore përveç çështjeve juridike të sipërpërmendura merret edhe me përfaqësime juridike në Gjykata.

Gjatë periudhës së raportimit në komunën e Hanit të Elezit ka pasur padi të ndryshme, por më shumë kemi padi për vërtetim të pronësisë, si zyre ju kemi bërë përgjigje në padi dhe kemi përfaqësuar komunën në Gjykata. Gjithashtu pas marrjes së aktgjykimeve në shkallën e parë të gjykatës kemi bërë ankesa në gjykatën e shkallës së dytë. Vlen të theksohet se nga gjykata e shkallës së dytë janë prishur një numër i konsiderueshëm i aktgjykimeve.

Për të gjitha llojet e padive duke respektuar Ligjin për procedurën kontestimore kemi bërë prapësime procedurale me përgjigje në padi në afatin ligjor, përfaqësimin e tyre me autorizim nga ana e Kryetarit të Komunës sipas ftesave të Gjykatës.

Vlen të theksohet se për shkak të mos zbatimeve të vendimeve administrative, pas plotfuqishmërisë së tyre debitorëve kemi bërë propozim për përmbarimin e vendimeve përmes përmbaruesit privat.

Zyra ligjore ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal dhe atë të Administratës Publike, në fushën e ligjshmërisë të akteve Ligjore dhe nënligjore.

Kjo zyrë ka bërë pajtueshmërinë e akteve ligjore në Komunë nëpër sektorë dhe kemi dhënë disa komentime lidhur me dispozitat e Ligjeve, Rregulloreve apo Udhëzimeve Administrative.

Kemi pasur një punëtori me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe me OSBE, ndërsa punëtori të tjera janë organizuar nëpërmes platformës digjitale me Zoom në distancë.

ZYRA E PROKURIMIT

Zyra e prokurimit gjatë muajëve Janar - qershor ka zhvilluar aktivitete duke u bazuar në Ligjet për Prokurim Publik Nr. 04/L-042 , LIGJI Nr. 05/068: dhe LIGJI Nr. 05/L-092, dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP)

Zyra e prokurimit gjatë këtij gjashtëmujori ka zhvilluar aktivitete të tenderimit duke përgatitur lendë dhe pagesa, dhe duke i dërguar në zyrën për financa.

Me ligjin në fuqi për çdo procedurë i drejtohem KRPP-së për sqarime dhe që i raportojme vazhdimisht KRPP-se për aktivitetet tona dhe çdo aktivitet shpallet në fjaen e KRPP-se.

Zyra e Prokurimit ka zhvilluar këto lloje të procedurave :

1. Procedura me vlera minimale mbi 100.00 € dhe me pak se 1,000.00 €
2. Procedura me vlera të vogla (1,000.00 € deri 10,000.00 €) dhe të mesme (mbi 10,000.00 €) **Procedura me vlera të vogla dhe të mesme vlerat mbi 1,000.00 € dhe me pak se 100,000.00 € (furnizime & shërbim & punë).**

P.S. Procedurat në proces janë procedura që janë duke u zhvilluar dhe nuk është përfunduar procedura e prokurimit për ato aktivitete!

Procedurat që janë zhvilluar për prokurimet mbi 1,000.00 € janë:

Nr .	Përshkrimi i projektit	Data e shpalljes së ofertës	Data e nënshkrimit të kontratës	Shuma e planifikuar	Shuma e projektit	Operatori fitues
1	<i>Botimi I vjetarit dhe materialit shtypes (banera, kese etj)</i>	17.02.2021	24.03.2021	€ 3,800.00	€ 2,660.00	NTG. "BLENDI" OP
2	Furnizim me peme dhe perime - MINITENDER	02.03.2021	06.04.2021	€ 1,800.00	€ 1,768.32	SKANDI; DONI Pr. shpk
3	Zhbllokimi I gypave te kanalizimit	18.02.2021	26.03.2021	€ 9,920.00	€ 9,765.00	EURO-PLUS shpk
5	Furnizim me material higjienik	03.03.2021	31.03.2021	€ 9,961.00	€ 7,600.05	LANTI PLAST shpk
5	Mirembajtja e ndricimit publik	07.03.2021	29.03.2021	€ 9,940.00	€ 7,979.90	BM Group shpk
6	Sherbime te vecanta - konsulente	10.03.2021	14.04.2021	€ 2,000.00	€ 1,980.00	Adnan Lusnjani
7	Rregullimi I ndricimit publik ne zonen urbane dhe rurale	16.04.2021	10.06.2021	€ 9,999.00	€ 9,751.00	RISAMONT shpk
8	Furnizim me material per mirembajtje	18.04.2021	18.05.2021	€ 9,950.00	€ 9,102.11	ELTELLA
9	Ndertimi I rezervuarit te ujesjellsit - Gorance	27.04.2021	30.06.2021	€ 24,990.00	€ 21,845.78	KUSHTRIMI-NM
10	Furnizim me pajisje sportive per nevoja te shkollave	27.04.2021	Ne proces			
11	Shpenzime interneti	07.05.2021	Ne proces			
12	Asfaltimi I rruges DARDANIA - Hani I Elezit	25.05.2021	Ne proces			
13	Shtrim me kubeza ne zonen urbane dhe rurale	28.05.2021	Ne proces			

Procedurat nën 1,000 €

Procedurat që janë zhvilluar për prokurimet mbi 1,000.00 € janë:

Nr .	Përshkrimi i projektit	Data e shpalljes së ofertës	Data kontratës	Shuma e planifikuar	Shuma e projektit	Operatori fitues
1	<i>Furnizim me material higjienik per nevoja te administrates komunale</i>	<i>25.01.2021</i>	<i>04.02.2021</i>	<i>997.50 €</i>	<i>978.00 €</i>	<i>"Euro Globi" Hani i Elezit</i>
2	Sigurimi dhe regjistrimi i vetures Toyota Prado (donacion nga UNMIK-u)	<i>03.02.2021</i>	<i>04.02.2021</i>	<i>530.00 €</i>	<i>515.93 €</i>	<i>K.S. "KOSOVA E RE" - Prishtinë</i>

3	Riparimi i vetures Hyundai ix35	08.02.2021	10.02.2021	520	498.20 €	Hyundai Autor SHPK - Prishtine
4	Furnizim me dollap per kabinetin e kimisë dhe biologjisë per SHML. Dardania	15.02.2021	16.02.2021	998	990	Exclusive Frasheri Center
5	Sherbime te publikimeve ne TV dhe Web faqe per prezantimin e aktiviteve te komunes	25.02.2021	01.03.2021	980	960	TV Dielli Media - Prishtinë
6	Furnizim me libra Fenikset e Lirisë	04.03.2021	10.03.2021	280	240	Radio Kosova e Lirë - Prishtinë
7	Furnizimi dhe montimi i kamerave ne SHFMU. I.Thaçi – Hani i Elezit	11.03.2021	24.03.2021	680	670.05	ELEKTRA Hani i Elezit
8	Furnizimi dhe montimi i perdeve te SHML. Dardania (Qendra per karrierë dhe ndërmarrësi)	08.03.2021	10.03.2021	837.2	800.8	Bashkim Dema B.I Hani i Elezit - Kaçanik
9	Akomodimi i asambleisteve brenda vendit – Boge (Pejë)	08.03.2021	11.03.2021	999	998	Magra Austria SHPK - Pejë
10	Furnizim me tavoline ping-pongu për SHFMU. “Keshjtella e Diturisë” - Paldenicë	08.06.2021	15.06.2021	300	290	Sporting - Prishtinë
11	Furnizim me TV per nevoja te kabineteve mesimore biologji, kimi – SHML. “Dardania” – H.Elezit	19.03.2021	22.03.2021	998	998	GAMA shpk - Ferizaj
12	Servisimi i veturave Hyundai ix35 dhe i20	25.04.2021	28.04.2021	631.2	622.55	Hyundai Auto shpk - Prishtinë
13	Servisimi i vetures KIA Sportage	05.05.2021	31.05.2021	997.4	973.14	Ideal Shala B.I. - Drenas
14	Furnizim me uniforma per nevoja te sigurimit fizik te objektit komunal	24.05.2021	26.05.2021	997	990	Igballe Thaçi B.I.
15	Furnizim me kosë bari	01.06.2021	02.06.2021	860	860	AGROLINDI - Ferizaj
17	Furnizim me maica me mbishkrim per javen kulturore, mirenjohje, fotografi dhe inqizime per Ditën e çlirimit	07.06.2021	09.06.2021	997.5	990	Foto Dernjani FSC
18	Furnizim me material sportiv per javen kulturore	07.06.2021	09.06.2021	597	559	Vlera Sport SHPK – Fushe Kosove

ZYRA PËR TRANSPARENCË

Raporti gjashtë mujorë i punës së zyrës së arkivit dhe transparencës

Zyra e transparencës në përputhje me planin e aprovuar të veprimit për vitin 2021, aktivitetin e vet e ka zhvilluar në kryerjen obligimeve në fushën e informimit publik sa më të mirë si të qytetarëve të komunës ashtu edhe opinionin sa më të gjerë për të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me zhvillimet në komunën tonë.

Në vazhden e aktiviteteve që kanë dalë nga këto obligime zyra e transparencës ka bërë informimet dhe njoftimet me kohë që dalin si obligime ligjore nga Rregullorja për transparencë, njoftimet me kohë për debate publike tematike, në të cilën janë propozuar për debat dokumentet e dala nga Kuvendi i Komunës.

Zyra e transparencës ka informuar me kohë lidhur me aktivitetet e organeve të komunës së Hanit të Elezit duke raportuar mbi aktivitetet e kryetarit të komunës dhe ekzekutivit, punën e Kuvendit të komunës dhe trupave të saja si dhe aktiviteteve tjera kulturore dhe sportive të cilat kanë qenë në interes të banorëve.

Është bërë botimi i publikimit “Vjetari 2020” në 500 kopje si dhe shpërndarja.

Gjatë këtij gjashtë mujori janë mbajtur 2 debate publike dhe 1 dëgjim buxhetor, si dhe takimet e Kryetarit të Komunës me qytetarët dhe mediat .

Gjatë këtij gjashtë mujori në komunën e Hanit të Elezit ka pas shume ngjarje dhe zhvillime te cilat zyra e informimit ju ka prezantuar qytetarëve të komunës sonë por edhe opinionit më të gjerë me informatat në faqen zyrtare në rrjetet sociale Facebook si dhe me shkrime në mjetet e informimit publik.

Në përputhje me Ligjin për qasje në dokumente publike 03/L-215 dhe udhëzimeve administrative përcjellëse, zyra për informim është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe raportimin periodik të zbatimit të këtij Ligji .

Gjatë këtij gjashtë mujori komuna e Hanit të Elezit ka pasur 5 kërkesa për qasje në dokumente publike të cilat kanë marrë përgjigjeje në afatet e parapara ligjore.

Në fushën e teknologjisë informative zyra e transparencës është angazhuar në mirëmbajtjen dhe funksionimit të pajisjeve, sistemeve dhe aplikacioneve teknike për zbatimin në realizimin e projekteve në kuadër të e-qeverisjes.

Sisitemi i TI-së ka qenë funksional dhe zyrtarët e qytetarët për as një moment nuk kanë mbetur pa shërbimet e nevojshme.

Qendra për Punë Sociale dhe Zyrës për Shërbimin e Pensionistëve, kanë qenë të kyqura pa pengesa në sisitemin e intranetit të komunës që ka mundësuar që zyrtarët të kryejn shërbimet për qytetarë përmes aplikacioneve përkatëse.

Gjendje stabile e funksionimit të sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë informative dhe pa ndonjë problem serioz që do të kushtëzonte intervenime jashtë institucionit të komunës, ka mundësuar funksionimin normal e të gjitha shërbimeve të nevojshme.

Gjatë këti gjashtë mujori nga buxheti i komunës nuk ka pas shpenzime të mjeteve buxhetore për mirëmbajtje të sistemit të TI-së ndërsa janë realizuar furnizime në pajisje për të cilat janë vlerësuar si të nevojshme.

Zyra e arkivit e komunës së Hanit të Elezit në përputhje me obligimet që dalin nga ligji për arkivimin e dokumenteve zyrtare , ka vazhduar me sistemimin, arkivimin si dhe me asgjësimin e dokumenteve jo arkivore. Sistemi i intranetit si dhe ndërlidhja e këtij sistemi

përmjet skenerit digital ka mundësuar zyrën e arkivit dhe administratën komunale që të ketë pasqyrë shumë më të mirë në rrjedhjen e dokumenteve si dhe arkivimin e tyre në mënyrë elektronike.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 janë përmes sistemit janë proceduar 4651 lëndë.

ZYRA PËR TË DERJTA E NJERIUT, FËMIJËVE DHE BARAZI GJINORE

1. Takimi mujor për Këshillin Komunal për Siguri dhe Bashkësi në Komunën e Hanit të Elezit i mbajtur më dt.26.02.2021 ora 14:00.

2. "8 Marsi Dita e Gruas" më dt. 08.03.2021 për nderë të festës së Gruas Zyra për Barazi Gjinore në kuadër të kësaj feste ka mbajtur takim brenda institucionit të Komunës së Hanit të Elezit takim me të punsuarat grate e institucionit dhe praktikantet-femra, me temë diskutimit rreth të drejtave të tyre dhe kërkesat e tyre rreth punës dhe vepres së tyre në institucion, ku po ashtu si pasojë e gjendjes me Covid-19 nuk kemi pasur mundësi të zgjerojmë rrethin në takim me gra të tjera jashtë institucionit komunal.

3. Më datë 12.03.2021 ish Presidentja e Republikës së Kosovës znj. **Atifete Jahjaga** vizitoi Shkollën e Mesme të Lartë "Dardania" në Komunën e Hanit të Elezit për ligjerata motivuese nëpër Kosovë.

Gjatë diskutimit ajo ndau me nxënësit, për mënyrën e depërtimit si grua në politikë dhe jo vetëm, për sfidat që hasin si grate për nevojën dhe domosdoshmërinë për përfshirjen e grave në institucione vendimarrëse.

Po ashtu ish presidentja pas vizitës së shkollës pati takimi edhe me Kryetarin Suma ku njoftoi znj. Jahjaga me zhvillimet në komunën e Hanit të Elezit.

Theks i vacant i bashkëbisedimit ishin investimet që komuna e Hanit të Elezit i ka realizuar në fushën e arsimit.

Gjatë diskutimit, znj. Jahjaga e përgëzoi Kryetarin Suma për punën e tij në Komunë si dhe për shërbimin e tij ndaj qytetarëve të Komunës.

U bisedua edhe për projektet e tanishme të Komunës si dhe për nevojat që ka Hani i Elezit dhe qytetarët e saj.

4. Punëtori më dt.26.03.2021 **Organizata Joqeveritare- Sundimi i Demokracisë** në Kosovë në bashkëpunim të ngushtë KKSBB-ën e komunës së Hanit të Elezit, organizon tryezë të përbashkët për projektin "**Mobilizimi rinor për parandalim të hershëm të ekstremizmit**" për të ofruar asistencë në hartimin e planit vjetor të veprimit të KKSBB-së, qëllimi është që ky plan veprimi të bashkëhartohet me pjesëmarrje të rinisë dhe ku do të i'u jepet më shumë rol rinisë edhe në implementim të aktiviteteve që ndërliken me luftimin e ekstremizmit.

5. Trajnimi-**Proceduar juridike për mbrojtjen e së drejtës kundër diskriminimit në Kosovë**, përmes platformës Zoom (takim virtual) më dt.01,02, dhe 06 Prill 2021 nga ora 10:00-15:00

6. Takimi mujor i KKSBB-së i mbajtur më dt.30.04.2021 nga ora 14:00

7. Trajnimi përmes platformës Zoom me temë "Diversiteti dhe Barazia në Republikën e Kosovës më datë 15 QERSHOR 2021 nga ora 10:30, dokumenti synon të matë perceptimin e përgjithshëm të popullatës në Kosovë lidhur me diversitetin në shumë aspekte të jetës së tyre, përfshirë ndikimin e pandemisë së COVID-19.

8. Takimi mujor i KKSBB-së më dt.28.05.2021 nga ora 14:00

9. Trajnimi i dytë më dt.16.06.2021 me **Organizaten Joqeveritare Sundimi i Demokracisë në Kosovë** me temë diskutimi "Mobilizimi rinor për parandalimin e hershëm të ekstremizmit".

10. Takimi mujor i KKSBB-së I më dt.25.06.2021 nga ora 14:00.

ZYRA KOMUNALE PËR KTHIM DHE KOMUNITETE

Zyra Komonale për kthim dhe Komunitete gjat gjasht mujorit 2021 planin e punës të parapar për vitin 2021 nuk kam mund ta realizojë sipas parashikimit të zyrës për arsye se nuk janë paraqitur asnjë i kthyer në ZKKK.

Gjatë gjashtë mujorit të parë që po e lëmë pas në zyrën për Komunitete dhe Kthim kam patur (4) katër kërkesa për vërtetim për të paraqitur te zyra e punësimit.

Gjatë kësaj periudhe janë lëshuar (4) vërtetime për aplikim në Zyrën e punësimit për mbështetje nga programi i riintegritimit dhe për plan biznese individuale.

Nga katër kërkesat të paraqitura ne zyren e punësimit nuk ka patur ndonji përfitues të ndonji biznesplanit apo ndonji përfitues tjetër për pagë prej 170 € ku aplikimi ende është i hapur për persona të riadhesuarve nga UNDP Zyra e punësimit ende është e hapur për aplikim.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2021, DAP-i ka ofruar shërbimet e veta qytetarëve dhe organeve tjera komunale (drejtorive, kuvendit dhe zyrave tjera) me të gjitha kapacitetet që i ka pasur në disponim.

Aktivitetet e drejtorisë së administratës për gjashtëmujorin e vitit 2020

Drejtoria e administratës së përgjithshme për periudhën Janar-Qershor 2021 aktivitetin e vet e ka orientuar kryesisht në përmbushjen e objektivave të cilat i ka parashtruar vetes në bazë të kompetencave dhe planit të punës për vitin 2021.

Drejtoria e Administratës një angazhim të madh dhe të veçantë ka pasur në drejtim të bashkëpunimit me MPB (Ministria e Punëve të Brendshme).

Bashkëpunimi me komunat e Republikës së Kosovës.

Pjesëmarrja në takimet e rregullta të bordit të drejtorëve si dhe pjesëmarrja në mbledhje të Kuvendit dhe KPF-së.

Pjesëmarrja në Dëgjimet publike të organizuara nga Komuna.

Drejtori i Administratës ka pasur takime me punëtorët e sektorit rreth punëve dhe problemeve të këtij sektori.

Përgatitja e raportit vjetor 2020 të Drejtorisë së Administratës.

Furnizimi i Administratës me material anti-COVID; masa mbrojtëse si doreza, maska, dezinfektues, etj.

Furnizimi i Administratës me material administrativ.

Furnizimi i administratës komunale me material higjienik.

Dorëzimi i raporteve çdo muaj në Entin e Statistikës së Kosovës dhe në departamentin e regjistrimit civil në Prishtinë.

Është bërë sigurimi dhe regjistrimi i veturave të Administratës sipas planifikimeve.

Servisimi i veturave është bërë sipas planifikimeve si dhe mirëmbajtja e tyre.

Trajnimi i zyrtarëve të administratës komunale.

Mirëmbajtja e rrjetit të intranetit dhe faqes zyrtare të Komunës.

Mbajtja e praktikës e disa studentëve në Administratën Komunale.

Mirëmbajtja e parkut të Komunës.

Shërbimi i Gjendjes Civile (SHGJC):

Ky shërbim operon me një zyre të Gjendjes Civile në ndërtesën Komunale në përbërje prej dy zyrtarëve.

Në Zyrën e Gjendjes Civile gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2021, janë lëshuar gjithësej **2571** dokumente nga SHGJC, duke përfshirë dokumentacionin e Gjendjes Civile si dhe dokumente (vendime, vërtetime, etj) sipas kërkesave të palëve.

Nr.	Lënda	Gjatë gjashtëmujorit 2020	Gjatë gjashtëmujorit 2021
1	Certifikata të Lindjes	387	339
2	Ekstrakte të Lindjes	1152	1,409
3	Certifikata të Martesës	327	248
4	Certifikata e Statusit Martesor	78	72
5	Certifikata të Vdekjes	128	90
6	Deklarata të Bashkësisë Familjare	311	193
7	Certifikata të Shtetësisë	17	15
8	Certifikata të Vendbanimit	257	162
9	Vërtetim të Mira Materiale	7	
10	Dëshmi të Vdekjes	9	
11	Vërtetim nga Arkiva	77	43
	Totali	2750	2571

Shprehur në shifra ky shërbim ka kryer këto shërbime për palë:

Aktvendimet e lëshura nga administrata gjatë gjashtëmujorit të vitit 2021

Nr.	Aktvendimet e lëshuara	Gjatë gjashtëmujorit 2020	Gjatë gjashtëmujorit 2021
1	Aktvendimet për regjistrim në LAL	n/a	n/a
2	Aktvendimet për regjistrim në LAV	2	3
3	Aktvendime për ndryshimin dhe përmirësimin e emrit dhe mbiemrit	n/a	8
4	Aktvendime për harmonizimin e datës së lindjes, vdekjes, harmonizimi gjinise dhe vendi i lindjes	1	n/a
5	Vërtetime mbi fitimin e shtetësisë së Kosovës	1	3
6	Aktvendim për anulim për regjistrim në LAL	5	1
	Totali	9	15

Qendra për shërbim të qytetarëve (QSHQ):

Ky sektor i DAP-it aktivitetin e vetë e bazon kryesisht në pranimin e kërkesave nga qytetarët dhe shpërndarjen e atyre kërkesave nëpër drejtori – zyrat përkatëse, si dhe pranimin e përgjigjeve (vendimeve) nga këto drejtori – zyra me qëllim të shpërndarjes së tyre deri tek qytetari i cili ka parashtuar kërkesë.

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2021, në QSHQ janë pranuar gjithsej **4651** kërkesa duke përfshirë edhe kërkesat për zyrën e regjistrimit civil.

Lëndë (kërkesa) të cilat ende nuk kanë marrë përgjigje dhe të cilat gjenden në procedurë janë gjithsej **111** lëndë.

Numri dhe struktura e lëndëve (kërkesave) të pranuar dhe përgjigjet (vendimet) e kthyer, sipas drejtorive-zyrave në gjashtëmujorin e vitit 2021, është si vijon:

Nr.	DREJTORITË	Kërkesa të pranuarat janar-qershor 2020	Lëndë të përfund. janar-qershor 2020	Kërkesa të pranuarat janar-qershor 2021	Lëndë të përfunduara janar-qershor 2021
1	Kuvendi Komunal	67	65	89	81
2	Zyra e Kryetarit	249	234	283	262
3	D. e Administratës	1656	1556	2,196	2,039
4	D.Buxhet dhe financa	561	529	662	592
5	D.Shërbime Publike dhe Emergjencë	32	30	36	35
6	D. BPZHR	24	23	906	882
7	D. Zhvillim Ekonomik	55	42	21	18
8	D. Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje Mjedisit	733	688	52	51
9	D. Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	103	98	209	205
10	D. Arsim Kulturë Rini e Sport	106	92	185	153
11	Zyra e prokurimit	7	5	12	10
	TOTALI :	3593	3362	4,651	4,328

Të hyrat që krijohen në DAP, bazohen në rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale. Ato gjatë periudhës Janar-Qershor 2021, janë realizuar në vlerë prej **2,229.00 €**, duke mos llogaritur ato kategori të cilat sipas vendimit komunal janë të liruar nga taksa.

Sektori për punë administrative

Sektori për punë administrative ka kryer punët dhe detyrat e punës për nevojat e Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit, Kryetarit të Komunës, Bordit të Drejtorëve dhe Drejtorit të Drejtorisë për Administratë. Ky sektor ka përgatitur ftesat dhe materialet tjera për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Komitetet Konsultative, Bordit të Drejtorëve, Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, etj. Kuvendi i komunës ka mbajtur **6** mbledhje të rregullta dhe **1** mbledhje solemne, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur **6** mbledhje të rregullta. Komiteti për komunitete ka mbajtur **6** mbledhje, tri komitetet konsultative kanë mbajtur **14** mbledhje, Komiteti konsultativ për persona me aftësi të kufizuara **4** mbledhje dhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur **6** mbledhje. Kuvendi i komunës ka miratuar: **19** vendime. Të gjitha këto akte normative të Kuvendit janë përgatitur për procedurë për nënshkrim dhe protokolim dhe janë dërguar në Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal për vlerësim të ligjshmërisë së këtyre akteve. Janë përgatitur **6** procesverbale të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe **6** procesverbale të Komitetit për Politikë dhe Financa, **6** procesverbale të Komitetit për Komunitete, **18** procesverbale të Komiteteve konsultative, **2** procesverbale të Komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara dhe **6** procesverbale të KKSB. Këshilli komunal për parandalimin e COVID19 ka mbajtur **2** mbledhje, ku janë përgatitur **2** procesverbale të këtyre mbledhjeve.

Janë përgatitur edhe **2** procesverbale të debateve publike lidhur me KAB 2021/23 dhe Raporti i punës së Kryetarit për gjashtë-mujorin e parë të vitit 2021. Gjatë kësaj periudhe raportuese, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur **26** mbledhje, ku janë shqyrtuar dhe aprovuar materialet të ndryshme të cilat janë përcjellë për shqyrtim dhe aprovim në KPF dhe në Kuvend.

Sektori i administrimit

Ky sektor përfshin shërbimet që kanë të bëjnë me mbështetjen logjistike të organeve të administratës dhe atë:

➤ Kujdesit për mirëmbajtjen e auto veturave zyrtare të organeve të administratës, veturat të jenë në gjendje të rregullt dhe përdorimin e tyre të rregullt dhe vetëm për punë zyrtare, sigurimin e objekteve komunale, organizimin e rojës dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale.

➤ Ushtron dhe menaxhon me racionalitet të plotë dhe të domosdoshëm me fushën e logjistikës ku përfshihet menaxhimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Hanit të Elezit, kujdeset për mirëmbajtjen e tyre, sigurimin, regjistrimin dhe shpenzimet e derivate të veturave zyrtare të Komunës.

Shpenzimet për derivate të naftës dhe benzinës për automjete, gjenerator dhe autorizime për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Hanit të Elezit gjatë periudhës Janar-Qershor janë **5.181** litra.

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA JANAR-QERSHOR 2021

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për periudhën janar – qershor 2021, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësiwe, në periudhën janar – qershor 2021 ishte e organizuar dhe ka funksionuar me tre (3) sektorë:

1. Sektori për buxhet dhe financa
2. Sektori për të hyra
3. Sektori i tatimit në pronë

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtori i drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë kësaj periudhe kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara.

Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Me qëllimin kryesor që të bëjmë një prezantim sa më gjithëpërfshirës të punëve dhe aktiviteteve të zhvilluara gjatë kësaj periudhe, në vazhdim me prioritet mbi të gjitha do të veçojmë:

1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

Ky sektor ka kryer këto aktivitete:

- Përpilimi dhe përgatitja e rrjedhës së parasë së gatshme për të gjitha programet dhe nën-programet buxhetore, me zotimet dhe shpenzimet e parashikuara të mjeteve buxhetore sipas dinamikës së planifikuar për periudhën gjashtë mujore 2021, nëpër të gjitha kategoritë ekonomike si: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione e transfere dhe investime kapitale.

- Përgatitja e propozim vendimit për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake 2020 në vitin vijues 2021 në shumë prej **57,779.88 €**.

- Përgatitja e raportit final të konsoliduar dhe analitik të bilancit të gjendjes për vitin 2020 dhe publikimi i tyre në ueb-faqen e komunës.

- Përgatitja e pyetësorit vetëvlerësues për vitin 2020 dhe përcjellja e tyre në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

- Përgatitja dhe hartimi i raporteve tremujore për ekzekutimin e buxhetit për periudhat: janar - mars 2020.

- Përgatitja dhe hartimi i raporteve mujore (janar-qershor) të buxhetit sipas drejtorive, sipas kategorive të shpenzimeve dhe publikimi i tyre në ueb-faqe të komunës.

- Përgatitja e pasqyrave financiare për vitin 2020 dhe përcjellja e raportit për Ministri të Financave-Departament te Thesarit me datën 29.01.2021.

- Nga data 21.04.2021 deri 22.06.2021, kemi pasur auditimin e brendshëm për vitin 2020 dhe periudhën janar-mars 2021 nga Ministria e Financave – Departamenti i Auditimit të Brendshëm, auditimi ka qenë në bazë të kërkesës së komunës së Hanit të Elezit (jemi në pritje të raportit nga DAB-MFPT).
- Nga data 20.05.2021 deri me datën kemi pasur auditimin e jashtëm për vitin 2020 nga Zyra Kombëtare e Auditimit (jemi në pritje të raportit të auditimit nga ZKA)
- Mbajtja e një debati publik me qytetarët me datën 18.06.2021 që kishte të bëjë me Kornizën afatmesme buxhetore Komunale për periudhën afatmesme 2022-2024.
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitet 2022-2024, ky dokument zhvillimor i miratuar në Kuvend Komunal me datën 29.06.2021, është dërguar në Ministri të Financave dhe publikuar në ueb-faqe të komunës.
- Përgatitja e raporteve për barazim me thesarin për vitin 2020, si dhe raportin për periudhën janar-qershor të shpenzimeve për vitin 2021.
- Përgatitja e nën-alokimeve të nën-programet e shkollave nëpër kategoritë ekonomike: mallra dhe shërbime, shpenzime komunale.
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave, të këshilltarëve komunal, komiteteve të ndryshme të kuvendit, të sektorit të arsimit dhe sektorit të kujdesit primar shëndetësor.

Në këtë periudhë raportuese janar - qershor 2021, nga të gjitha programet dhe nën-programet buxhetore sipas kërkesave të parashtruara janë iniciuar procedurat duke u bërë zotimi i mjeteve në 710 urdhër zotimi për pagesa (UZP), pastaj është vazhduar me procedimin e tyre në formë të shpenzimeve dhe aprovimi i të gjitha shpenzimeve për të gjitha kërkesat e parashtruara dhe vendimet e marrura për shpenzime, prej të cilave përfundimisht me gjendjen e datës 30.06.2021, janë ekzekutuar në total 690 pagesa, ku shumica e mjeteve është në lartësi prej 370,948.58 € ku përfshihen kategoritë ekonomike mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, ndërsa shpenzimet për kategorinë ekonomike paga dhe shtesa të cilat menaxhohen dhe mbikëqyren nga MFPT-ja janë në shumë prej 810,386.79 €.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2021 është në lartësi prej **2,520,165.91 Euro**, ndërsa ai përfundimtar është **2,684,502.11 €**.

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR

KESH	Buxheti 2021	Realizimi TM2	%	Buxheti 2020	Realizimi TM2	%
Paga dhe shtesa	1,650,453.41	810,386.79	49.10%	1,537,196.00	768,907.83	50.02%
Mallra dhe shërbime	353,165.39	157,735.16	44.66%	329,203.45	126,562.94	38.45%
Shpenzime komunale	67,000.00	25,274.42	37.72%	60,000.00	22,500.10	37.50%
Subvencione dhe trans.	80,290.00	33,885.00	42.20%	81,240.87	34,300.00	42.22%
Shpenzime kapitale	478,593.31	154,053.92	32.19%	762,727.19	115,914.83	15.20%
Rezervat	55,000.00	-	0.00%	168,787.00	-	0.00%
TOTALI	2,684,502.11	1,181,335.29	44.01%	2,939,154.51	1,068,185.70	36.34%

2021/2020

Komente dhe shpjegime:

➤ Pagesat nga kategoria ekonomike **paga dhe shtesa** janë shpenzuar në shumë prej 810,386.79 € ose 49.10% të planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 pagesat për këtë kategori kanë një rritje për 41,478.96 €.

➤ Pagesat për këtë kategori ekonomike **mallra dhe shërbime** për gjashtëmuorin e parë 2021 janë 157,735.16 € apo 44.66% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 kemi një rritje prej për 31,172.22 €.

➤ Pagesat për **shërbime komunale** për gjashtëmuorin e parë 2021 janë në shumë prej 25,274.42 € apo 37.72% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 kemi një rritje prej 2,774.32 €.

➤ Pagesat nga kategoria **subvencione dhe transfere** për gjashtëmuorin e parë 2021 janë në shumë prej 33,855.00 apo 42.20% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020 kemi një rënie të lehtë prej 415.00 €.

➤ Pagesat nga kategoria **shpenzimet kapitale** janë në shumë prej 154,053.92 € apo 32.19 % e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë kemi një rritje prej 38,139.09 €.

➤ Gjithsejtë **shpenzimet për periudhën janar-qershor 2021**, për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve janë në shumë prej 1,181,335.29 € apo 44.01% e planit të përgjithshëm vjetor, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rritje për 10.59 % apo 113,149.59 €.

2. SEKTORI PËR TË HYRAT

Në kuadër të këtij sektori janë kryer këto aktivitete:

➤ Përpunimi, harmonizimi dhe barazimi i evidencave të detajizuara të të gjitha llojet e të hyrave sipas programeve buxhetore, fondeve dhe kodeve ekonomike në Sistemin informativ të menaxhimit financiar të Kosovës (SIMFK).

➤ Përgatitja e raporteve për barazim me thesarin si: barazimin mujor, tremujor me të hyrat vetanake.

➤ Përgatitja e raporteve për të hyrat vetanake për periudhën janar-maj 2021 sipas drejtorive, sipas llojit të të hyrave dhe publikimi i raporteve në ueb-faqe të komunës.

➤ Mbajtja e evidencave të sakta dhe shtimi i efikasitetit në arkëtimin dhe bankimin e pagesave – inkasimet në arkë, depozitimet bankare, transferi i të hyrave komunale dhe alokimin e këtyre mjeteve sipas planifikimit të drejtorive.

RAPORT I TË HYRAVE VETANAKE PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2021

Nr	Përshkrimi	Planifikimi 2021	Realizimi TM2 2021	Realizimi TM2 2020	Progresi në (%) ndaj planit	Krahasoni në euro TM2 2021-2020
		1	2	3	4=2/1	5=2/3
1	Certifikatat e lindjes	182	45	20	24.73%	25
2	Certifikatat e	600	250	230	41.67%	20

	kurorëzimit					
3	Certifikatat e vdekjes	160	26	22	16.25%	4
4	Certifikata tjera ofiqarie	5,200.00	1,887.00	1,577.00	36.29%	310
5	Taksa për verifikimin e dok. të ndrysh.	70	21	10	30.00%	11
6	Taksa administrative	100	-	35	0.00%	-35
I	Administrata e Përgjithshme	6,312.00	2,229.00	1,894.00	35.31%	335
7	Tatimi në pronë dhe në tokë	147,203.00	86,175.60	54,921.01	58.54%	31,254.59
8	Taksë për regjistrim të automjeteve	15,200.00	8,060.00	7,290.00	53.03%	770
II	Buxhet dhe Financa	162,403.00	94,235.60	62,211.01	58.03%	32,024.59
9	Të hyrat nga reklamimet publike	6,000.00	1,840.00	840	30.67%	1,000.00
10	Licenca tjera për afarizëm	300	240	90	80.00%	150
11	Taksa tjera administrative	800	180	110	22.50%	70
12	Gjjobat tjera	300	-	-	0.00%	-
III	Shërbimet Publike	7,400.00	2,260.00	1,040.00	30.54%	1,220.00
13	Të hyrat nga ushtrimi i veprimt. afariste	77,500.00	56,325.33	42,257.29	72.68%	14,068.04
14	Licenca për pranim teknik të lokalit	100	20	10	20.00%	10
IV	Zhvillimi Ekonomik	77,600.00	56,345.33	42,267.29	72.61%	14,078.04
15	Taksa komunale për leje ndërtimi	5,000.00	7,534.89	4,061.95	150.70%	3,472.94
16	Taksa komunale për demolim	100	-	-	0.00%	-
17	Taksë për bartjen e pronësisë	2,782.00	2,940.00	965	105.68%	1,975.00
18	Ndërrim destinimi i tokës	500	-	100	0.00%	-
19	Shërbime të ndryshme kadastrale	6,000.00	4,918.50	2,674.00	81.98%	2,244.50
20	Taksë për legalizim të objekteve	-	1,592.22	242.85	0.00%	1,349.37
21	Shfrytëzimi i pronës publike	5,720.00	1,189.86	152.6	20.80%	1,037.26
22	Të hyrat nga shitja e pasurisë	-	6,640.00	-	0.00%	6,640.00
23	Gjjobat nga inspektorati	130	-	460	0.00%	-
24	Gjjobat tjera	100	-	-	0.00%	-
V	Urbanizimi dhe Kadastri	20,332.00	24,815.47	8,656.40	122.05%	16,159.07
25	Participimet në Arsim	8,250.00	6,080.00	-	73.70%	6,080.00

VI	Arsimi	8,250.00	6,080.00	-	73.70%	6,080.00
26	Taksa për shërbimet sociale	200	62	20	31.00%	42
27	Certifikata mjekësore	1,000.00	870	540	87.00%	330
28	Participimet në shëndetësi	5,027.00	3,054.70	4,057.50	60.77%	-1,002.80
29	Inspektimi Higjeniko-Sanitar	100	10	10	10.00%	-
VI I	Shëndetësia dhe MS	6,327.00	3,996.70	4,627.50	63.17%	-630.8
A	TË HYRAT DIREKTE	288,624.00	189,962.10	120,696.20	65.82%	69,265.90
30	Të hyrat nga dënimet në trafik	-	2,550.00	8,420.00	0.00%	-5,870.00
31	Të hyrat nga dënimet në gjykata	-	-	-	0.00%	0
B	TË HYRAT INDIREKTE	-	2,550.00	8,420.00	0.00%	-5,870.00
TOTALI I PËRGJITHSHËM (A + B)		288,624.00	192,512.10	129,116.20	66.70%	63,395.90

PLANIFIKIMI I TË HYRAVE

➤ Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2021 është në shumë prej 288,624.00 €.

➤ Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë **192,512.10 €** të hyra vetanake për periudhën janar-qershor 2021 apo 66.70% e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 kemi një rritje prej 63,395.90 € më shumë apo 49.10%.

➤ Në bazë të drejtorive kemi këto të hyra:

- drejtorja për buxhet dhe financa ka mbledhur të hyra në shumë prej 94,235.60 €;
- drejtorja e zhvillimit ekonomik ka mbledhur në shumë prej 56,345.33 €;
- drejtorja e urbanizmit në shumë prej 24,815.47 €;
- drejtorja e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në shumë prej 3,996.70 €;
- drejtorja e shërbimeve publike në shumë prej 2,260.00 €;
- drejtorja e administratës komunale në shumë prej 2,229.00 €, si dhe të hyrat nga
- dënimet në trafik janë në shumë prej 2,550.00 € për periudhën janar-mars 2021, ndërsa për tremujorin prill-qershor 2021 ende nuk na kanë ardhur të dhënat për shumën e të hyrave.

3. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë kësaj periudhe, kjo zyre ka pasur këto aktivitete:

➤ Kryerja e të gjitha punëve organizative, informative dhe zbatimi i formave më efektive për fillimin e punës për vitin 2021.

➤ Gjatë muajve shkurt-mars 2021 është bërë shpërndarja e faturave të tatimit në pronë dhe në tokë (printimi, zarfimi, përshkrimi dhe dërgimi i tyre) përmes zyrtarëve që kanë qenë të kontraktuar nga ana e komunës, ku numri i faturave ka qenë 2,793.

➤ Sipas dispozitave ligjore, pas pranimit të faturave të tatimit në pronë dhe në tokë, qytetarët kanë parashtruar 168 kërkesa për korrigjim ndaj çertifikatës së pronës dhe 54 ankesa ndaj faturës së tatimit në pronë, ku nga këto kërkesa dhe ankesa të gjitha janë shqyrtuar nga komisioni i ankesave.

➤ Gjatë periudhës janar-qershor 2021 kemi arritur të bëjmë 10 marrëveshje për pagesën me këste të tatimit në pronë.

➤ Faturimi i tatimit në pronë dhe në tokë për vitin 2021 në komunën e Hanit të Elezit është 147,203.00 Euro, ndërsa totali inkasuar i tatimit në pronë dhe tokë për periudhën janar-qershor 2021 është 86,175.60 Euro apo 58.54 % nga planifikimi duke përfshirë borxhet, kamatën dhe ndëshkimet nga vitet e kaluara.

DREJTORIA PËR ARSIM , KULTURË , RINI DHE SPORT

DKAKRS-ja gjatë periudhës gjashtëmujore janar-qershor 2021 ka kryer punët dhe detyrat të cilat kanë ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe ngritjen e cilësisë në mësim përmes pajisjes së shkollave me material të nevojshëm si dhe organizimin e trajnimeve për mësimdhënës.

Janë mbajtur takimet në MASHTI, me Inspektorët e punës, me KFOR-in, Policinë e Kosovës OSBE-në. Takime të rregullta me bordin e Drejtorëve, drejtorët e shkollave dhe Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Hanit të Elezit, TASK FORCËN Komunale dhe Këshillin për parandalimin e Korona virusit COVID-19.

DKAKRS gjatë kësaj periode ka bërë përgatitjen e materialit për furnizimin e kabineteve për SHML “Dardania”. Gjithashtu kemi përgatit materialin për furnizim me mjete për sallat e edukatës fizike të shkollave të cilat pritet se shpejti me ardhë. Kemi bërë edhe përgatitjen e materialit për shujtat e mësimdhënësve.

Këtë vit u bë edhe përrurimi i sallës së sporteve në fshatin Gorancë që do të jet ne shërbim të nxënësve dhe rinisë së fshatrave.

Nga Janari i këtij viti ka filluar punën edhe institucioni parashkollor (Çerdhja) ku janë krijuar kushte të volitshme për gjithëpërfshirje në arsim të gjitha moshave.

Drejtoria duke u bazuar në strukturën e organizimit dhe funksionimit të DKAKRS-së në bazë të udhëzimit administrativ të MASHTI-it, kryesisht është orientuar në krijimin dhe mbikëqyrjen e kushteve normale për punë të institucioneve edukativo-arsimore në tri nivele:

Niveli 0: Arsimimi parashkollorë (mosha nga 06-5 vjet) dhe parafillor mosha e fëmijëve prej(5-6 vjet).

Niveli 1: Arsimimi fillorë prej moshës 6 vjet.

Niveli 2: Arsimimi i mesëm i ulët prej moshës 12 vjet dhe

Niveli 3: Arsimimi i mesëm i lartë prej moshës 15 vjet.

Aktivitetet:

Vizita në shkollat e Komunës së Hanit të Elezit, kryesisht është inspektuar në mbarëvajtja e procesit mësimor, realizimi i orëve mësimore, përgatitjet e orëve mësimore dhe higjiena nëpër objektet shkollore Këtë gjashtëmujor për shkak të Pandemisë COVID-19, mësimi është mbajtur kryesisht sipas skenarit A që dmth me prezencë në shkollë po sipas Udhëzimeve të IKSHP-së dhe MASHTI-it klasat janë nda në dy grupe. Në Komunën tonë vetëm një javë është mbajtur mësimi ONLINE nga data 12.04.2021 deri më 16.04.2021 edhe atë nga klasa e 6-ta deri ne klasat e 12-ta, ndërsa klasat e parë deri ne klasën e pestë kanë mbajtur mësim ne

shkollë. Gjatë vizitave iu ka kushtua rëndësi e veçantë respektimi i udhëzimeve nga Instituti Kombëtar Shëndetësor i Kosovës MASHTI si dhe Ministria e Shëndetësisë.

Qëllimi i vizitës:

1. Punimi i plan-programeve nga ana e arsimtarëve.
2. Rendi dhe rregulli i kujdestarisë nga ana e arsimtarëve në ambientin e shkollës.
3. Mbajtja e higjienës në ambientin e shkollës.
4. Respektimi i udhëzimeve për mbrojtje nga COVID-19.

Gjatë këtyre vizitave janë dhënë këto rekomandime drejtorëve të shkollave që të përmirësojnë:

1. Shërbimet profesionale.
2. Të ketë kontroll të rregullt në aspektin e sigurimit të cilësisë në arsim.
3. Të ketë kontroll në aspektin higjeno-teknik
4. Të zbatohet kurikula në të gjitha nivelet (këtë vit përfundoi zbatimin e kurikulave në të gjitha nivelet)

5. Të respektohen udhëzimet për mbrojtjen nga Korona virusi COVID-19.

Shqyrtimi i shpenzimeve të buxhetit të vitit 2021 sipas planifikimeve dhe planifikimet buxhetore për vitin fiskal 2022 me drejtorët e shkollave.

Planifikimi i Buxhetit të arsimit për vitin 2022/2023/2024 sipas qarkores së parë buxhetore të lëshuar nga MEF-i.

Përveç këtyre aktiviteteve kemi pasur edhe:

- Mbledhje të rregullta javore me TASK FORCËS Komunale.
- Është hap Konkursi për bursa të studentëve dhe është bërë ndarja e tyre.
- Takim në MASHTI - Ndarja e çmimit “SHABAN JASHARI” Nga Hani i Elezit

Mirënjohje si mësimdhënës i dalluar ishte Miqail Vila.

- Trajnim në Ferizaj : Planifikimi buxhetor efikas.
- Trajnim dy ditorë – “Menagjimi i rasteve me fëmijët me nevoja të veçanta
- Takim me përfaqësues të GIZ-it për Hartimin e hartave zonale
- Takim me Kolegjiumin e Drejtorëve të Arsimit
- Takim në MASHTI- Funkcionalizimi i Ekipeve për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

• Takim me Asociacionin e Komunave-Fuqizimi i Kuvendeve Komunale.

• Takim në MASHTI-Problemet në shkolla dhe përgatitja për përfundimin e vitit mësimorë.

• Takim me MASHTI- Testi i arritshmërisë dhe testi i maturës: testi i arritshmërisë të mbahet me 28.05.2021, ndërsa testi i maturës më 26.06.2021.

Takime dhe Aktivitete tjera në Komunë.

- Takim ONLINE me OJQ-në “TOKA”
- Takim me KFOR-in Polak.
- Takim me OSBE-në me Komitetin e komunitetit me nevoja të veçanta.
- Kemi bërë përgatitjen e materialit për shujta të mësimdhënësve.
- Takim me përfaqësuesit e KVRL-së.
- Punëtori për finalizimin e PZHK-së.
- Akademi përkujtimore për Dëshmorët e Krivenikut.
- Takim me përfaqësuesit e “HANDIKOS”-it të Kaçanikut
- Takim me përfaqësuesit e “Riinvestit”

- Takim me Shtabin emergjent për parandalimin e COVID-19
- Takim me Beqir Krasniqin përfaqësues i BB – Përkrahja e Rinisë
- Takim me KFOR-in Polak te Çerdhja
- Takim me përfaqësuesit e Trashëgimisë Kulturore te Ferizajt mundësia e financimit të ndonjë projekti.
- Takim me përfaqësuesit e USAID-it Trajnime për Rini
- Takim me profesorët e ed. Fizike Formimi i Këshillit organizativ për garat shkollore për nder te 11 qershorit.
- Takim me organizatën “NIRAS”-Aktivitetin “Ditët e informimit për cilësinë e ajrit”.
- Takim me Këshillin organizativ për “Javën Kulturore”.
- Turniri në futboll të vogël për nder të Ditës së Çlirimit.
- Takim me Artan Binakun-Përfaqësues i CDF-së – Mbajtja e një ligjëratë në SHML “Dardania”.
- Takim ONLINE me KOK – Organizimi i Ditës Olimpikë me fëmijët e Pavarësisë.
- Takim me KKSMB-Mobilizimi rinor për parandalimin e ekstremizmit te dhunshëm.
- Komuna e Hanit të Elezit në 20 vjetorin e rënies përkujton Dëshmorin Elham Curri.
- Akademia për Dëshmorin Nehat Curri.
- Dita Olimpikë-Vrapimi i fëmijëve të lindur në vitin 2008 Vitin e Pavarësisë.
- Takim me Lorenta Kadriun-Përfaqësuese e “Partners of Kosova” – Mbajtja e trajnimeve me të rinjtë në 5 departamente te Komunës.
- Në Krivenik homazhe te Pllaka përkujtimore dhe te varri i Dëshmorit Ilaz Thaçi-Shënim i Ditës së shkollës “Ilaz Thaçi”.
- Trajnim_Tema; “Së bashku për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm në Kosovë.
- Përfundimi i mësimit me maturant: 26.05.2021 me klasa të 9,10,11 me datën 17.06.2021 ndërsa me klasat 1-8 me datën 02.07.2021.
- U mbajt testi i Arritshmërisë më: 28.05.2021, ndërsa testi i maturës më datën 26.06.2021 (më gjerësisht në raportin e suksesit të nxënësve në fund të vitit mësimor 2020/2021).

AKTIVITETE TË NXËNËSVE

Gjatë periodës dytë dhe te tretë krahas procesit edukativo-arsimor në shkollat tona edhe pse nen kushte pandemie janë zhvilluar gara diturie në të gjitha nivelet dhe atë në të gjitha nivelet dhe me të gjithë nxënësit.

Janë zhvilluar gara sportive ne futboll, volejboll dhe pingpong si për meshkuj ashtu edhe për femra, në nivel shkollë dhe në nivel Komune.

Në të gjitha shkollat për ditë shkollë dhe festa te tjera kemi pasë ekspozita të punimeve të nxënësve në fushën e artit figurativ.

RAPORTI PËR KULTUR RINI, DHE SPORT 2021

1	17.02.2021	Hani i Elezit shënon 13 vjetorin e Pavarësisë së Republikës të Kosovës Edhe pse në kushte të pandemisë së Koronavirusit me numër të kufizuar të pjesëmarrësve, shënoi ditën e Pavarësisë së Republikës të Kosovës. Ky aktivitet filloi me Homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në Pustenic për të nderuar sakrificën e Dëshmorëve të trevës së Hani të Elezit. Aktivitetet vazhdoi në SHFMU”Ilaz Thaçi” në Han të Elezit ku të ftuar ishin përfaqësues të Familjeve të Dëshmorëve. Për pjesën kulturore dhe artistike u kujdesën nxënës të SHFMU”Ilaz
---	------------	---

		Thaçi”me recitale dhe SHKA”Sharri” pika muzikore dhe valle.
2	20.02.2021	Klubi i mundjes” Dardania”- Hani i Elezit së, organizatore teknike, nën mbështetjen e Federatës mundjes së Kosovës, njëkohësisht presidenti z. Naim Muja ka përfunduar me sukses turneun pavarësia në Hani të Elezit. numri i kufizuar me 50 shikues nën masat mbrojtëse për shkak virusit Corona.
3	16.03.2021	Komuna e Hanit të Elezit në 20 vjetorin e rënies përkujton Dëshmorin Elham Curri. Aktivitetet vazhdoi në SHFMU”Ilaz Thaqi”në Han të Elezit ku të ftuar ishin përfaqësues të Familjeve të Dëshmorëve. SHKA”Sharri” me këngë kushtuar Dëshmorit Elham Curri dhe Dëshmorëve tjerë, kënduan rapsodët Adem Bllaca dhe Nesim Curri .
4	27.03.2021	Më datën 27 mars në Komunën e Hanit të Elezit nën patronatin e Federatës së Mundjes të Kosovës. organizatore teknike Klubi i mundjes” Dardania”nga Hani i Elezit. Klubi i mundjes” Dardania”- merrë titullin e parë në edicionin e garave për vitin 2021 .
5	29.03.2021	Komuna e Hani i Elezit në 20 vjetorin e rënjes përkujton Dëshmorët: Baki Krasniqi, Ilaz Thaqi, dhe martirët Raif Thaqi dhe gazetari i ndjer Karem Lawton. SHKA”Sharri” me këngë kushtuar Dëshmorëve këduan rapsodët, Avni Bushi Adem Bllaca dhe Nesimi Curri.
6	06.04.2021	Në ambientet e SHFMU”Ilaz Thaqi”në Han të Elezit u mbajt Akademi Përkujtimore me rastin e 40 vjetorit të Demonstratave të vitit 1981. Në këtë Akademi, krahas pjesëmarrësve të tjerë, të pranishëm ishte edhe Hydajet Hyseni. Hyseni nga Shoqata e të burgosurve Politik. Akademia u përmyll me një program kulturo artistik nga SHKA”Sharri”.
		Java kulturore komuna Hani i Elezit
7	01.06.2021	Fëmijët e komunës së Hanit të Elezit shënojnë "1 Qershorin" Ditën ndërkombëtare të fëmijëve. Me këtë aktivitet ma të vegjlit e Komunës edhe zyrtarisht fillojnë aktivitetet e "Javës Kulturore"
8	02.06.2021 09.06.2021	Turnir në futboll të vogël nën organizimin Komunës përkatësisht Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport që u mbat në fushën e hapur tek Shkolla e mesme (SHML) “Dardania” Fituese doli ekipi “Rinia”, vend i parë dhe vend i dytë “11Qershori”
9	05.06.2019	Mbahet takimi tradicional poetik “Eksodi Bllaca 99” e përkujtuan poetet Artistët dhe rapsodët .
10	06.06.2021	Garat shkollore në futboll per djem dhe vajza Salla e sportit SHFMU”Ilaz Thaçi”
11	08.06.2021	Garat shkollore në ping pong(SHML) “Dardania” djem dhe vajza
12	08.06.2021	Garat shkollore volejboll djem dhe vajza Salla e sportit SHFMU”Ilaz Thaçi”
13	11.06.2021	Ekspozitë me nxënës.
14	11.06.2021	Hani i Elezit shënoi 22 vite të Çlirimit Pas një vragë të aktiviteteve kulturore dhe sportive në kuadër të “Javës Kulturore”, Komuna e Hanit të Elezit sot shënoi 11-Qershorin Ditën e Çlirimit të Hanit të Elezit. 22 vjetorit të çlirimit të Hanit të Elezit filloi me seancë solemne e cila iu

		kushtua kësaj dite të shënuar të historisë më të re të Hanit të Elezit dhe të mbarë popullit të Kosovës. Manifestimi qendrorë u mbajt në ambient të hapur te fusha e sportit “Dardania”ku pati një program kulturo artistik me këngë e valle popullore nga SHKA”Sharri” Hani i Elezit. Si dhe musafyr patëm Këngëtarin Arian Agushi(GOLD AG).
15	21.06.2021	Me Akademi përkujtimore shënohet 20 vjetori i rënjes së Dëshmorit të Kombit Nehat Curri. Akademia u përmyll me pika muzikore nga këngëtarët Avni Bushi dhe Milahim Mezini.
16	23.06.2021	U shënu krosi tradicional i Komitetit Olimpik të Kosovës të gjeneratës së vitit 2008
17	27.06.2021	Përfundon me sukses turneu “Trofeu i paqes”në mundje, për nder të ditës së Çlirimit të Qytetit të Hanit të Elezit,ku pjesëmarrës ishin ekipet e Kosovës, Maqedonisë veriore dhe Shqipërisë.
18	28.06.2021	Përurohet Salla sportive në Fshatin Gorancë të Komunës së Hanit të Elezit për nxënësit e SHFMU “Veli Ballazhi.

SPORT -2021

Siç jemi në njohuri këtë vit me vendim të Qeverisë së Kosovës edhe sporti sikurse aktivitetet tjera u lejuan po nën kushte dhe rrethana te pandemisë sipas Udhëzimeve të IKSHPK dhe Ministrisë së Kulturës dhe Sportit.

Përveç Klubit të futbollit dhe Klubeve te Mundjes që kanë zhvilluar aktivitetet, Komuna ka organizua sikurse viteve tjera Turnirë si ne futboll ashtu edhe ne mundje dhe volejball.

Është organizuar “Java Kulturore sipas skenarëve te ma hershëm me përjashtim te Krosit qe nuk është organizua për shkak të mos grumbullimit të masave.

Janë mbajt Turniri në futboll te vogël si dhe garat shkollore në futboll, volejball dhe ping-pong si për meshkuj ashtu edhe për femra.

Është mbajt edhe turneu Ndërkombëtar i mundjes ku klubi “Dardania” korri suksese te kënaqshme.

DREJTORIA URBANIZËM KADASTËR DHE MBROTJE TË MJEDISIT

I PLANIFIKIMI

Në fushën e planifikimit të dokumenteve strategjike, Komuna ka arritë rezultate të kënaqshme pavarësisht faktit se fillim viti ishte i ndikuar nga probleme të krijuara si rezultat i veprimit të pandemisë Covid 19.

a. Plani Zhvillimor Komunal (PZHK): Ka përfunduar hartimi i PZHK-s pavarësisht vonesave të theksuara si rezultat i numrit të vogël të ekspertëve të fushës të angazhuar në hartimin e sajë si dhe veprimit të pandemisë. Përndryshe tani me rradhë janë procedurat e organizimitit të diskutimeve publike me qytetar dhe grupe të interesit, marrja e pëlqimit (konfirmimit) nga Ministria e Planifikimit Hapësinor se i njejt është në pajtim me Planin Hapësinor të Republikës së Kosovës si dhe miratimi nga Kuvendi i Komunës.

b. Harta Zonale e Komunës (HZK): Ky plan strategjik hapësinor po hartohet në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman i cili përmes procedurave të tenderimit ka përzgjedhur kompaninë “Plan A Consulting” për hartimin e HZK-s. Vlera e këtij projekti është 50,000€ prej të cilave 35,000€ i financon GIZ-i kurse Komuna 15,000€. Hartimi i këtij dokumenti është në fazën finale dhe po zhvillohet në pajtim me programin e hartimit të HZK-s të miratuar nga Kuvendi i Komunës.

c. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVM): Ka përfunduar hartimi i PLVM-s dhe i njejt i është dorëzuar (në fund të muajit Qershor) Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim. Përndryshe ky dokument i rëndësisë së veçantë nga fusha e planifikimit mjedisor është financuar nga buxheti i Bashkimit Evropian në kuadër të IPA fondeve-Programi për bashkëpunim ndër-kufitar në mes të Kosovës dhe Maqedonisë Veriore 2014-2020. Dokumenti është hartuar nga grupi punues i Komunës dhe kompania “Environment & Business Solutions”.

II PROJEKTET INVESTIVE KAPITALE

Sektori i Urbanizmit në vazhdimësi ka qenë i angazhuar në të gjitha projektet investive kapitale përmes:

- Përgaditjes së paramasave dhe parallogarive për projektet kapitale të parapara për realizim vitin 2021,
- Mbikqyrjes së vazhdueshme të punimeve në teren dhe ndihma punëkryesve në realizimin e projekteve,
- Përgaditjen e aplikacion projekteve për donator të ndryshëm,
- Përgaditjen e raporteve për projektet kapitale për Komunë, raporteve progresive të projekteve për zyrën e prokurimit etj.

Më poshtë po japim listën e projekteve investive kapitale si dhe statusin e tyre momental:

Lista e projekteve investive kapitale për vitin 2021 në kuadër të DUKMM

Nr .	Emri i projektit	Finacues i i projektit	Buxheti	Punë kryesi	Statusi momental i projektiti	Kohë zgjatja
1	Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Han të Elezit	Komuna	908,980	ATCCOM	Në perfundim	2019,2020 dhe 2021
2	Ndërtimi i sallës së sporteve në SHFMU Veli Ballazhi Gorancë	MKRS, Komuna, MAPL, MZHR	316,346	ATCCOM	E perfunduar	2020, 2021

3	Shtirim me kubëza betoni në zonat urbane dhe rurale Hani Elezit	Komuna	106,900		E tenderuar	2021
4	Rregullimi i kanalizimeve neper zonat urbane dhe rurale te Hanit te Elezit	Komuna	20,000		Projekti është në fazën para tenderuese	2021
5	Ndërtimi (rihapja dhe zgjerimi) i rrugëve në zonat rurale (Asfaltimi i rrg. Dardania)	Komuna	55,000		Në fazën para tenderuese	2021
6	Ndërtimi i trotuareve per këmbësor në zonat urbane dhe rurale	Komuna	10,000		Në fazën e paratenderimit	2021
7	Ndërtimi i mureve mbrojtëse neper zonat urbane dhe rurale	Komuna	5,000		Faza pergaditor e	2021
8	Rregullimi i parkut ne rrugen “Isa Berisha” (asfaltim, trotuar, ndriçim publik dhe gjelbrim)	Komuna	10,000		Faza pergaditor e	2021
9	Fond për hartimin e projekteve	Komuna	5,127		Faza pergaditor e	2021
10	Rregullimi i varezave te qytetit	Komuna	10,000		Faza pergaditor e	2021

Shënim: Në listën e projekteve kapitale janë paraqitur vetëm projektet me kod 66480 Planifikimi Urban dhe Inspeksioni dhe jo projektet e tjera të cilat janë në listat e Drejtorive tjera.

III LEJET NDËRTIMORE

Gjatë kësaj periudhe, janë regjistruar 11 aplikime për leje ndërtimore dhe janë dhënë 9 leje ndërtimore. Në raport me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar numri i lejeve të dhëna ndërtimore është për dy leje më shumë.

Regjistri i lejeve ndërtimore të dhëna në gjashtëmujorin e parë:

1. Zekirja Vila, Kategoria I, sip. 229.46 - taksa kom. 229.46€,
2. Rabije Vila, Kategoria I, sip. 197.7m² –taksa kom. 197.7€,
3. Driton Luri, Kategoria I, sip.308.5m²-taksa kom. 308.5€,
4. Ajdin Daci, Kategoria I, sip. 345.6m²-taksa kom. 345.6€,
5. Zekije Dernjani, Kategoria I, sip. 133.12-taksa kom. 133.12€,
6. Maliq Berisha, Kategoria I-P+1, sip.225.45m²-taksa kom. 225.45€
7. Lulzim Bushi, Kategoria I-P+1, sip.211m²-taksa kom. 211€
8. Islam Curri, Kategoria II-B+P+5, sip.3131.8m²-taksa kom. 3,131.8€.
9. “Luri”sh.p.k. Kategoria II-P+O, sip.773.7m² –taksa kom. 773.7€

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, nga taksa komunale për leje ndërtimore janë realizuar të hyra në shumë prej 5,556.33€ apo 38.5% më shumë se periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

IV TRAJTIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE NDËRTIMORE (LEGALIZIMI)

Nga fillimi i muajit Qershor vitit 2020, Komuna e Hanit të Elezit respektivisht Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit ka filluar me trajtimin e ndërtimeve pa leje ndërtimore sipas Ligjit të ri nr.06/L-024 për trajtimin (legalizimin) e ndërtimeve pa leje të kategorisë parë dhe kategorisë dytë i cili ka hyrë në fuqi me 5 Shtator 2018. Me këtë Ligj, janë reduktuar kërkesat për numrin e dokumenteve të cilat kërkohen për legalizim si dhe është mundësuar ulja e kostos (shpenzimeve) për aplikim. Ligji, gjithashtu parasheh hartimin dhe aprovimin e programeve të veqanta për trajtimin e ndërtimeve pa leje në prona publike, prona shoqërore, toka bujqësore nën komasacion dhe nën sistem të ujitjes, koridore infrastrukturore, sipërfaqe të mbrojtura, zona të veqanta të mbrojtura etj.

Përndryshe në Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit në fillim vit apo gjashtëmujorin e parë kanë aplikuar dymbëdhjetë qytetar për legalizim të objekteve ndërtimore pa leje dhe që të gjitha janë paisur me çertifikatë të legalizimit. Nga këto 12 aplikues gjashtë prej tyre janë liruar nga pagesa e taksës Komunale për legalizim meqense të njëjtat janë ndërtime para vitit 2004. Të hyrat e realizuara në emër të taksës për legalizim për periudhën e lartëpërmendur janë në shumë prej 1,211€ apo 113.5% më shumë se gjashtëmujorin e parë të vitit paraprak. Vlerësojmë se numri i të interesuarve për legalizim të ndërtimeve pa leje ndërtimore ende mbetet tepër i ulët dhe kjo është ma shumë si pasojë e situatës së krijuar me Corona 19 si dhe çmimet e larta të shërbimeve Kadastrale të operatorëve të licencuar për ofrim të këtyre shërbimeve.

Ndërkaç sa i përket uzurpimeve të pronës Komunale, në periudhën raportuese nuk është vërejtur apo raportuar ndonjë rast i uzurpimit.

V SHFRYTËZIMI I TOKËS NDËRTIMORE DHE OBJEKTIT BANESOR (NDËRTEA E TË VETMUARVE) PRONË E KUVENDIT KOMUNAL

Sa i përket shfrytëzimit të tokës pronë e Kuvendit të Komunës si dhe shfrytëzimit me qira të objektit banesor (ndërtesa e të vetmuarve) po ashtu pronë Komunale nuk ka asnjë ndryshim në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Edhe më tutje janë 23 shfrytëzues me kontratë të tokës pronë e Kuvendit Komunal (ku janë të vendosura kryesisht lokalet me karakter të përkohshëm, garazhe etj.) si dhe gjashtë shfrytëzues të objektit banesor (banesa e të vetmuarve-pesë prej tyre për qëllime të banimit dhe njëri për lokal). Sipërfaqja e përgjithshme e tokës të dhënë me qera është 424.8m² ndërkaq sip. e banesave të dhëna me qera është 392.5m². Faturimi vjetor për shfrytëzuesit e pronës Komunale (tokës dhe banesave) është 6,042€. Përndryshe në periudhën Janar-Qershor 2021, Drejtoria ka inkasuar në emër të taksës për shfrytëzim të pronës Komunale shumë prej 1,189 € që është për 94.5% më shumë se periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

VI MBROJTJA E MJEDISIT

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë bërë inspektime të rregullta nga inspektorja e mjedisit dhe aty ku është parë e arsyeshme janë bërë vërejtje me gojë dhe shkrim (procesverbale). Sektori i mjedisit në vazhdimësi ka monitoruar ndotjen nga “SharrCem” ku me shkresë zyrtare i jemi drejtuar Sharrcemit me qrast kemi shprehë paknaqësitë tona dhe të qytetarëve lidhur me ndotjen e ajrit ku kemi kërkuar që të marrin masa për parandalimin e ndotjes së ajrit.

Për shkak të situatës së krijuar me pandeminë Covid 19 dhe ndalimit të tubimeve Komuna nuk ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të Tokës, të Mjedisit si dhe aktivitete të tjera të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit. Sektori i Mjedisit së bashku me MMPH ka bërë identifikimin e deponive ilegale dhe në bashkëpunim me kompaninë “Pastrimi” është bërë pastrimi dhe eliminimi i tyre. Po ashtu, në periudhën raportuese sektori i mjedisit ka lëshuar dy leje mjedisore të cilat ndërlidhen me dy ndërtime të kategorisë II.

Të hyrat e sektorit të Mjedisit gjashtëmujorin e parë të vitit 2021

Emërtimi	Gjashtëmujori parë 2020	Gjashtëmujori parë 2021
Të hyrat nga gjobat mandatore	240 €	0,00 €
Të hyrat nga pëlqimet mjedisore	2,119 €	1,968 €
Gjithësej	2,359 €	1,968 €

VII KADASTRI

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, Kadastri ka shënuar shtim të numrit të kërkesave respektivishtë lëndëve nga 688 sa ishin në gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar në 848 sivjet ose 160 lëndë më shumë. Ky shtim i lëndëve më së shumti i dedikohet përmirimit të situatës së krijuar me Covid 19 sidomos në muajt Maj dhe Qershor.

Raporti i lëndëve të kryera në gjashtëmujorin e parë 2021 viti

Nr.	Emërtimi i kërkesës	Numri i kërkesave	Pagesa
1	Qertifikata prone	382	1,089 €
2	Kopje plani	178	575 €
3	Bartje pronësie	80	2,370 €
4	Ndarje fizike të parceleve	28	1,520 €
5	Blerje të pikave	109	900,5€
6	Bashkim të parceleve	9	220 €
7	Vërtetim që nuk posedon pronë	18	30 €
8	Modifikim pronësie	0	0,00€
9	Regjistrim hipoteke	4	580 €
10	Ç’regjistrim hipoteke	3	0.00 €
11	Historiat të parceleve	1	90 €
12	Regjistrim objekti (njësi banesore)	6	20.00 €

13	Korigjim të sipërfaqeve	16	100 €
14	Përgjigje në kërkesa për info. kadastrale	0	0.00 €
15	Kërkesë për heqjen e masës së përkohshme	2	0,00€
16	Kontrata për shfrytëzim të pronës Komunale	1	0.00 €
17	Kërkesë për modifikim të parceleve	6	260 €
18	Të tjera të ndryshme	5	0.00 €
19	Taksa për shfrytëzim të pronës publike		1,189,86 €
	GJITHËSEJTË:	848	8,944.36 €

Në periudhën Janar-Qershor Kadastri ka realizuar të hyra në shumë prej 8,944.36 € apo për 108.3% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

TË HYRAT E DREJTORISË PËR GJASHTËMUJORIN E PARË 2021

Të hyrat e Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, në gjashtëmuorin e parë të vitit 2021 janë në shumë prej 17,679€ apo 65.7% më të mëdha se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Të hyrat e drejtorisë për periudhën Janar-Qershor 2019

U r b a n i z m i	6,767 €
K a d a s t r i	8,944 €
M j e d i s i	1,968 €
Gjithësej	17,679 €

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Gjatë periudhës Janar- Qershor 2021 DSHMS ka pasur këto aktivitete :

- ✓ Takime të vazhdueshme me Ministrinë e Shëndetësisë.
- ✓ Marrëveshje për kryerjen e shërbimeve nga Kompania NPL Pastrimi.
- ✓ Dërgim i listës për priorite në vaksinim kundër Covid-19: lista e punëtorëve shëndetësorë dhe lista e pacienteve me sëmundje kronike, dërgim në MSH (me kërkesë të MSH).
- ✓ Kërkesë për Islamic Relief WorldWide, për vazhdim të marrëveshjes së bashkëpunimit edhe për vitin 2021.
- ✓ Furnizmi me barna dhe material shëndetësor nga MSH.
- ✓ Ndërpreje e kontrolla mjekësore në pikën kufitare nga pandemia COVID-19.
- ✓ Pramin i 500 testeve raporida për Covid-19.
- ✓ Dërgimi i listave për shtesat në COVID-19 në rrezikshmëri gjatë punës për punëtorët shëndetësorë.
- ✓ Takim me kforin polak, situata me Covid-19, nevojat.
- ✓ Kërkesë nga MSH për nevojat në QKMF: Autoambulance, veturë, gjeneratorë.
- ✓ Përgaditja e orarit për gadishmëri për barnatorët që operojnë në komunën e Hanit të Elezit

- ✓ Përgaditja e orarit të barnatoreve për kujdesatari gjatë ditëve të diela dhe gjatë festave zyrtare.
- ✓ Rregullimi i shenjave orientuese për QKMF.
- ✓ Takim me MSH dhe përgjegjesit e njësive të vaksinimit rreth organizimit dhe procedurave për imunizim me vaksinën kundër COVID-19.
- ✓ Takim me Ministrin e Shëndetësisë për situatën me COVID-19 dhe informatë rreth funizimit dhe procesit të vaksinimit nëpër QKMF.
- ✓ Përgaditja e dhomës për vaksinimin në QKMF.
- ✓ Përrurimi i klasave për nëna dhe fëmijë nga AMC.
- ✓

QENDRA KRYESORE E MJEKESISE FAMILJARE DR’’MENDUH KALOSHI ‘’

Gjatë periudhës Janar- Qershor QKMF ‘’Dr.Menduh Kaloshi’’ ka kryer detyrat e zakonshme që i përkasin këtij institucioni.

▪ Sektori i Mjekësisë Familjar

Në Sektorin e Mjekësisë Familjare janë ofruar këto shërbime shëndetësore:

Kontrollat mjekësore për të gjitha moshat dhe gjinitë nga mjeku –(dy mjek/e), Orari 07:00^h 15:00^h

Vizitat shtëpiake për të sëmuarit paliativ (të palëvizshëm).

Vizitat shtëpiake tek pacientët me COVID-19.

Shërbimet laboratorike dhe RTG si dhe leximin e tyre.

Shërbimet specialistike konsultative nga Pediatri dhe Internistri.

Imunizimi – Vaksinimi.

Shërbimet e triazhimit .

Shërbimet mjekësore administrative – SISH (Sistemi i Informimit Shëndetësor) tani online.

Muajt	Kartoteka		Intervenime	
Viti	2020	2021	2020	2021
Janar	2,862	1478	3,515	3103
Shkurt	2,455	1418	2,782	2590
Mars	1,979	2112	1,979	2175
Prill	869	1735	1,027	2496
Maj	974	1734	1,352	1714
Qershor	1,630	2219	1,378	2393
Totali	10,769	10,696	12,033	14,471

▪ Sektori i shëndetit publik

Analiza e të dhënave, sistematizimi dhe raportimi i rregullt kanë qenë objektivat e realizimit në Njësinë e Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH) .

Sektori i Vaksinimit ka kryer vaksinimin e rregullt të të gjitha grupmoshave, të dy gjinive sipas kalendarit të vaksinimit. Vaksinimin e rregullt i fëmijëve deri në moshën 19 vjeçare (sipas kalendarit të vaksinimit) dhe rastet e lëndimit me vaksinën Antitetanike mbi moshën 19 vjeçare.

Gjithashtu është duke vazhduar vaksinimi kundër COVID-19.

Muajt	Vaksinimi		Vizitat për Nëna dhe fëmijë	
	2020	2021	2020	2021
Janar	70	56	47	66
Shkurt	47	156	35	55
Mars	50	162	16	69
Prill	00	302	00	66
Maj	86	57	45	52
Qershor	107	41	35	45
Totali	360	774	178	353

▪ **Sektori i Diagnostikës**

